



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1238/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Latif Vllasaliu kandidate për anëtar të kuvendit komunal nga radha e LDK-së në Novobërdë, paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës te votave, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Latif Vllasaliu, kandidate për anëtar të kuvendit komunal në Novobërdë, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

Me datën 03.12.2013 në ora 16:00, Latif Vllasaliu kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radha e LDK-së në Novobërdë ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se në dy vendvotime me nr. :1403D dhe 1413D ka pasur manipulime me votën tij, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Latif Vllasaliu nga radha e LDK-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi apo provë, për të vërtetuar shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1238/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.